

**Trajtimi i pavullnetshëm në spital**

1. Emri i pacientit	
2. Emri i mjekut përgjegjës për trajtimin tuaj	
3. Emri i spitalit dhe pavioni	
4. Data kur filloi procesi i trajtimit të pavullnetshëm	

**Pse jam në spital?**

Ju po mbaheni në spital sipas kritereve të parashikuara në nenin 20, 21, 22, 23 dhe 24 të ligjit 44/2012 'Për Shëndetin Mendor'. Kjo do të thotë se dy mjekë mendojnë se ju keni një sëmundje mendore dhe për këtë arsye është e nevojshme që ju të qëndroni në spital për të marrë trajtimin dhe shërbimin e përshtatshëm.

**Sa gjatë duhet të qëndroj në spital?**

Ju do të qëndroni në spital derisa mjeku përgjegjës për trajtimin tuaj të gjykojë se jeni mjaftueshëm mirë për të dalë nga spitali. Nëse kushtet tuaja shëndetësore nuk përmirësohen, ose ju nuk pranoni trajtimin në mënyrë të vullnetshme, atëherë brenda tre ditëve nga data e shtrimit, spitali do i dërgojë gjykatës së rrethit gjyqësor një kërkesë për mbajtjen tuaj në spital. Ju do të merrni një kopje të kësaj kërkesë.

Gjatë kësaj periudhe, si dhe në rast se gjykata e rrethit gjyqësor aprovon trajtimin e pavullnetshëm, ju nuk duhet të largoheni nga spitali. Nëse ju përpiqeni të largoheni, atëherë stafi mund t'ju ndalojë, dhe në rast se largoheni, ju mund të silleni sërish pas në spital.

### **Çfarë trajtimi do më japin gjatë kësaj kohe?**

Mjeku përgjegjës për trajtimin tuaj dhe anëtarë të tjerë të personelit do t'ju informojnë mbi cdo trajtim që ata mendojnë se ju keni nevojë. Në shumicën e rasteve ju duhet të pranoni dhe ndiqni këshillat e tyre.

### **A kam të drejtë të ankohem?**

Ju mund të flisni me mjekun tuaj përgjegjës, ose me çdo anëtar të stafit në çdo moment që mendoni se vendimi për trajtim të pavullnetshëm është i padrejtë, ose nëse mendoni se jeni gati që të pranoni trajtimin e rekomanduar në mënyrë të vullnetshme.

Gjithashtu dhe familjari dhe/ose përfaqësuesi juaj ligjor mund t'i kërkojnë gjykatës kërkesë për rishikimin e vendimit për trajtimin e pavullnetshëm.

### **Informimi i familjarit tuaj më të afërt**

Një kopje e këtij formulari informues , si dhe e kërkesës për në gjykatë do t'i jepet dhe familjarit tuaj më të afërt. Në rastin tuaj, si familjari juaj më i afërt është identifikuar:

--

Në rast se ju nuk dëshironi që ky person i identifikuar si familjari juaj më i afërt të informohet në lidhje me gjendjen tuaj shëndetësore, thuajini mjekut ose infermieres suaj.